

Kërkesë për Shprehje të Interesit

Shteti: Kosovë

ID e projektit: P164555

Emri i kredisë së Bankës Botërore: Projekti i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore

Nr. identifikues i kontratës: XK-KCA-404824-CS-INDV

Specialist i Komunikimit/Marrëdhënieve me Publikun

Historiku

Qeveria e Kosovës (QK) ka marrë një Kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 14.60 milion EUR për të financuar Projektin e Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore, që pritet të zbatohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Projekti i propozuar synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të rrisë transparencën dhe cilësinë e administrimit të tokës dhe të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është agjencia zbatuese për projektin REGIP, brenda së cilës do të krijohet Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP). NjIP do të ketë Koordinatorin e NjIP-it, Specialistin e Prokurimit, Specialistin e Menaxhimit Financiar, Specialistin për Marrëdhënie me Publikun dhe Komunikim dhe staf tjetër teknik si Ekspertë për GIS, Specialist për TI, etj.

NjIP do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përditshëm të projektit dhe për ofrimin e mbikëqyrjes teknike specifike të aktiviteteve të projektit. NjIP do të jetë përgjegjëse për të gjitha aspektet e besueshmërisë, siç janë prokurimi, menaxhimi financiar, monitorimi dhe vlerësimi, dhe masat mbrojtëse sipas Projektit.

Komponentët e projektit janë Komponenti A - Politika, Mbështetja Ligjore dhe Institucionale; Komponenti B - Modernizimi i Kadastrit; Komponenti C - TIK dhe Infrastruktura Gjeohapësinore dhe Komponenti D - Menaxhimi i Projektit, Ngritja e Kapaciteteve, Informimi i Publikut dhe Monitorimi dhe Vlerësimi.

Përgjegjësitë e Specialistit të Komunikimit/Marrëdhënieve me Publikun

Specialisti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun në kuadër të Projektit do të duhet të sigurojë që strategjitë e komunikimit, marrëdhëniet me mediat, përfshirja sociale e grupeve të ndjeshme në përdorimin e të drejtave pronësore dhe përpjekjet organizative për komunikim të jenë në përputhje me politikat dhe iniciativat e komunikimit korporativ.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Specialistit të Komunikimit/Marrëdhënieve me Publikun janë të shënuara në Termat e Referencës për këtë detyrë. TeR mund të gjendet në linkun e uebfaqes së AKK-së <https://akk.rks-gov.net/sq/shpallje> dhe <https://akk.rks-gov.net/en/shpallje>

Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë universitare ose Master në komunikim ose shkenca shoqërore.
- Së paku katër (4) vite përvojë pune si Zyrtar i Marrëdhënieve me Publikun, Komunikimit dhe Informimit.
- Njohuritë në sektorin e pronës në Kosovë janë përparësi.
- Njohuritë dhe përvoja e punës me organizata ndërkombëtare janë përparësi.
- Preferohen aftësi në dizajn grafik, njohuri të Indesign, Photoshop, HTML, CSS, Liferay CMS.
- Përvojë të dëshmuar dhe histori të suksesshme në zbatimin e strategjive dhe teknikave të angazhimit të qytetarëve dhe palëve të interesit.
- Njohuri dhe kuptim të gjerë të çështjeve të zhvillimit, kontekstit social-politik, ekonomik dhe kulturor të vendit.
- Aftësi të demonstruar për t'u marrë me mediat dhe palët e ndryshme të interesit, duke përfshirë shoqërinë civile dhe grupet e avokimit në nivel lokal dhe kombëtar.
- Aftësi të shkëlqyera në shkrim, të folur, prezantim, ndërpersonale si dhe aftësi për të punuar bashkërisht në një mjedis ekipor me shumë palë të interesit.
- Aftësi të demonstruara për të promovuar dhe zbatuar reforma të ndjeshme në një mjedis kompleks.
- Aftësia për të funksionuar në një mjedis të paparashikueshëm, të drejtuar nga afatet, duke nxjerrë materiale sipas planit dhe menaxhimin e të tjerëve në përmbushjen e standardeve dhe afateve.
- Kërkohej njohja e rrjedhshme e gjuhës angleze dhe shqipe në të shkruar dhe të folur. Njohja e gjuhës serbe është shumë e dëshirueshme.

Periudha e performancës

Specialistit i Komunikimit/Marrëdhënieve me Publikun do të punojë me kohë të plotë dhe kohëzgjatja e kontratës pritet të jetë nga marsi i viti 2024 deri në përfundimin e projektit. Kohëzgjatja e kontratës do t'i nënshtrohet performancës së kënaqshme të rënë dakord gjatë vlerësimit zyrtar të planifikuar në fund të çdo viti. Paga do të kryhet në bazë të tarifës mujore të rënë dakord në kontratë. Konsulenti pritet të fillojë shërbimet me nënshkrimin e kontratës.

Procesi i përzgjedhjes:

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), korrik 2016, bazuar në thirrjen e hapur.

Kriteret e vlerësimit:

- Kualifikimi i përgjithshëm - 30 pikë
- Përvoja specifike në lidhje me detyrën – 70 pikë

Konsulentët individualë të interesuar mund të marrin informacione të mëtejshme në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës: 08:00 - 16:00 (nga e hëna në të premten)

Shprehja interesi (CV e detajuar me referenca përkatëse për përvojat e punës dhe kopja e diplomës(ave) për studimet universitare të përfunduara) duhet të dorëzohen në formatin në PDF në prokurimi.regip@rks-gov.net jo më vonë se **12 Shkurt, në orën 15.00 (koha lokale)**.

Agjencia Kadastrale e Kosovës

Specialisti i Prokurimit

Adresa: rr. "Astrit e Arbnor Dehari" nr. 25

10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail: prokurimi.regip@rks-gov.net